



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

UDHËZIM

MBI
RAPORTIMIN E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR ZBATIMIN E SNRF 17
“KONTRATAT E SIGURIMIT”

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 146, datë 31.08.2023

Në mbështetje të neneve 3, 12, dhe 14, pikat 2 dhe 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhërit nr. 106/2023 “Për shtyrjen e afatit të aplikimit të standardit ndërkombëtar të raportimit financiar SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

- Duke konsideruar faktin se shoqëritë e sigurimit, si njësi ekonomike me interes publik, hartojnë dhe raportojnë pasqyrat financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), pjesë e të cilave është edhe SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”;
- Duke vlerësuar se zbatueshmëria e SNRF 17 parashikohet të ketë efekt të gjerë mbi paraqitjen e pasqyrave financiare, si dhe të sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë në metodologjinë e llogaritjes së provigjoneve dhe vlerësimin e tyre.
- Duke konsideruar se përveç vlerësimit të provigjoneve me vlerë tregu, përfshihen edhe koncepte të reja, si: marzhi i shërbimit kontraktor, rregullimi i rrezikut, etj., zbatimi i SNRF 17 pritet të ketë efekt edhe në pasqyrat financiare, përfshirë edhe rezultatin financiar të shoqërive të sigurimit;
- Me qëllim marrjen e masave nga shoqëritë e sigurimit për zbatimin e SNRF 17, brenda afatit të përcaktuar,

UDHËZON:

1. Shoqëritë e sigurimit të vlerësojnë faktorët e ndikuar nga SNRF17, të cilët lidhen me qëndrueshmërinë e veprimtarisë dhe aftësitë e tyre për aplikimin e plotë dhe në kohë të këtij standardi.
2. Organet drejtuese/menaxhimi i lartë i shoqërive të sigurimit të angazhohen për hartimin e planit të punës për implementimin e SNRF 17. Këto organe duhet të miratojnë çdo informacion të kërkuar nga Autoriteti lidhur me këtë çështje.
3. Shoqëritë e sigurimit, në përputhje me planin e masave të hartuar sipas kërkesave të Autoritetit, të raportojnë çdo gjashtë muaj, lidhur me angazhimet e marra dhe ecurinë e zbatimit të SNRF 17.
4. Shoqëritë e sigurimit të testojnë përllogaritjet aktuariale dhe ndryshimet në mbajtjen e kontabilitetit të shoqërisë, nga një auditues ligjor.
5. Raportimi i shoqërive të sigurimit në Autoritet, të kryhet sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Afatet dhe mënyra e raportimit

Periudhat e raportimit sipas përcaktimit të pikës 4 të këtij udhëzimi do të jenë:

- 31 janar 2024;
- 31 korrik 2024;
- 31 janar 2025, i cili është edhe raportimi përfundimtar dhe pasqyron në mënyrë të detajuar të gjitha zhvillimet që nga momenti i fillimit të aplikimit të SNRF 17, deri në zbatimin e plotë të tij.

b) Format i raportit

Raporti mbi zhvillimet dhe masat e marra nga shoqëritë e sigurimit, duhet të depozitohet në Autoritet në formë të shkruar dhe elektronike, përfshirë edhe “Pyetësin përmbledhës të vetëvlerësimit SNRF 17”, sipas shtojcës bashkëngjitur këtij udhëzimi.

c) Përmbajtja e raportit

Raporti duhet të përmbajë të dhëna të detajuara lidhur me statusin dhe çdo vendim të mundshëm të marrë nga shoqëria e sigurimit, minimalisht si më poshtë:

i) Strukturën e dedikuar dhe burimet për zbatimin e SNRF 17

Në raport do të përshkruhet struktura e shoqërisë së sigurimit e angazhuar në procesin për implementimin e SNRF 17, organet drejtuese të saj, afati kohor, roli dhe përgjegjësitë konkrete të çdo anëtari të kësaj strukture, si dhe vetëvlerësimi mbi mjaftueshmërinë e burimeve në fuksion të zbatimit të SNRF 17.

ii) Opinionin e pavarur të audituesit ligjor

Opinionin e pavarur të audituesit ligjor mbi llogaritjet aktuariale dhe përshtatjen e mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit, sipas kërkesave të SNRF 17.

iii) Statusi i zbatimit të planit të masave

Shoqëritë e sigurimit duhet të informojnë për ecurinë e zbatimit të planit të masave, nëse ai është në afat, përpara afatit ose me vonesë, si dhe mbi statusin e çështjeve kryesore të tij. Nëse zbatimi i SNRF 17 nuk është sipas afatit të parashikuar, shoqëritë e sigurimit duhet të informojnë për hapat që po ndërmarrin për ta rikthyer atë në afat.

Përveç sa më sipër, në zbatimin e planit të masave, shoqëritë e sigurimit duhet të:

- Kryejnë një vlerësim cilësor dhe tërësor të ndryshimeve aktuariale dhe të atyre në kontabilitet të SNRF 17/SNRF 4 (p.sh. ndikimi në provigjone, rezultatin financiar, kapitali rregullator, etj.);
- Identifikojnë problematikat dhe zgjidhjet në zbatimin e SNRF 17 duke evidentuar: “ku është marrë një vendim dhe kur një vendim nuk është marrë, faktorët kryesorë të rëndësishëm për vendimin dhe afatin kohor për përfundimin e atij vendimi”;
- Përshkruajnë zgjedhjet e mundshme, veprimet, zgjedhjet ose politikat (kontabël ose aktuariale) që merren parasysh dhe kriteret e zbatueshme në marrjen e një vendimi;
- Aty ku një vendim është përcaktuar dhe është e mundur të vlerësohet ndikimi i tij, të jepet një vlerësim paraprak i ndikimeve sasiore për çdo zë të pasqyrave financiare të ndikuar nga zgjedhja dhe ndikimi i mundshëm në treguesit e shoqërisë.

iv) Ndikime të rëndësishme aktuariale dhe kontabël

Në raport duhet minimalisht të përfshihen një përmbledhje e ndryshimeve të rëndësishme të shkaktuara nga diferencat midis SNRF 4 dhe SNRF 17. Disa nga politikat kontabël që mund të ndikojnë në vlerësimet aktuariale dhe pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit paraqiten si më poshtë:

- Niveli i agregimit për portofol/grup kontratash sigurimi;
- Vlerësimi i detyrimeve ndaj policëmbajtësve;
- Vlerësimi i flukseve të ardhshme të parasë;
- Normat e skontimit;
- Rregullimi i rrezikut;
- Marzhi i shërbimit kontraktor;
- Kontabiliteti për kontratat me elemente të garancive financiare;
- Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim;
- Metoda e shpërndarjes së primit;
- Risigurimi;
- Ndikimi i SNRF 9, p.sh. klasifikimi dhe matja e instrumentave financiare, etj.

Plani i masave duhet të trajtojë çështjet si më sipër dhe çdo element tjetër që ka ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit, përfshirë njohjen, klasifikimin, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese.

v) Përgatitja nga pikëpamja operationale

Në raport shoqëritë e sigurimit duhet të përditësojnë vlerësimin e tyre për ndikimin e SNRF 17, lidhur me:

- Përgatitjen e formateve për qëllime raportimi;
- Ndryshimet e nevojshme në sisteme;
- Trajnimet e dedikuara dhe të ofruara për stafin; dhe
- Çdo element tjetër që ndikon në zbatimin e SNRF 17.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Shtojcë

Emri i shoqërisë:

Data e raportimit:

Statusi						
IFRS 17- Pyetësor vetëvlerësimi	Përfunduar	Në proces - në afat	Në proces - paraqet rrezik për vonesë	Pa filluar	I pazbatueshëm	Komente
1	A ka shoqëria një plan masash të miratuar për SNRF 17?					
	A është ky plan duke u zbatuar sipas afateve të parashikuara?					
2	<p>A i ka përcaktuar shoqëria politikat e saj kontabël në lidhje me SNRF 17, duke përfshirë opsionet dhe metodat aktuariale të lidhura me?:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nivelin e agregimit për portofol/grup kontratash sigurimi; • Vlerësimin e detyrimeve ndaj policëmbajtësve; 					

Emri i shoqërisë:

Data e raportimit:

Statusi

IFRS 17- Pyetësor vetëvlerësimi	Përfunduar	Në proces - në afat	Në proces - paraqet rrezik për vonesë	Pa filluar	I pazbatueshëm	Komente
<ul style="list-style-type: none">• Vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë;• Normat e skontimit;• Rregullimin e rrezikut;• Marzhin e Shërbimit Kontraktor• Kontabilitetin për kontratat me elemente të garancive financiare;• Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim;• Metodë e shpërndarjes së primit;• Risigurimin;• Ndikimin e SNRF 9, p.sh. klasifikimi dhe matja e instrumentave financiare, etj.						
3 A ka kryer shoqëria një vlerësim cilësor të efektit të ndryshimeve SNRF 4/SNRF 17?						

Emri i shoqërisë:

Data e raportimit:

Statusi						
IFRS 17- Pyetësor vetëvlerësimi	Përfunduar	Në proces - në afat	Në proces - paraqet rrezik për vonesë	Pa filluar	I pazbatueshëm	Komente
4 A ka kryer shoqëria një vlerësim të ndryshimeve në pasqyrat financiare sipas SNRF 17?						
5 A ka kryer shoqëria një analizë të ndikimit të SNRF 9 në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare?						
6 A janë vlerësuar nevojat për ndryshime në sistemet e të dhënave?						
7 A ka parashikuar dhe ofruar shoqëria trajnime për stafin?						
8 A ka rishikuar dhe vlerësuar shoqëria ndikimin e SNRF 17 në treguesit financiarë?						

Emri i shoqërisë:

Data e raportimit:

Statusi						
IFRS 17- Pyetësor vetëvlerësimi	Përfunduar	Në proces - në afat	Në proces - paraqet rrezik për vonesë	Pa filluar	I pazbatueshëm	Komente
9 Çështje të tjera: <ul style="list-style-type: none">• a)• b)• c)						